



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 1082/44 Prot.

Tiranë, më 30.05.2020

V E N D I M

Nr. 56, Datë 30.05.2020

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 12 SUBJEKTE PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA PËR PERIUdhËN 01.01.2019 DERI 22.08.2019, RESPEKTIVISHT BASHKITË: KURBIN, TROPOJË, LIBRAZHD, PUKË, MAT, GRAMSH, BULQIZË, FUSHË-ARRËZ, TIRANË DHE 3 INSTITUCIONE NË VARTËSI BASHKISË TIRANË, DREJTORIA E KONVIKTEVE DHE SHKOLLAVE TË MESME, TIRANA PARKING DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me qëllim përmirësimin e gjendjes.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportet Përfundimtare të Auditimit "*Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019*", të ushtruar në 12 subjekte, Bashkitë: **Kurbin, Tropojë, Librazhd, Pukë, Mat, Gramsh, Bulqizë, Fushë-Arrëz, Tiranë dhe 3 Institucione në vartësi të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Konvikteve dhe Shkollave të Mesme, Tirana Parking dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik (ish-Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit)**, sipas programit të auditimit nr. 1082, prot., datë 28.12.2019, ndryshuar me shkresën nr. 1082/11, prot., datë 02.03.2020, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të rikërkoj zbatimin e tyre, për sa vijon:

Gjatë kryerjes së këtij auditimi janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së, nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Mbi kthimin e përgjigjes të zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda afatit 20 ditor, hartimi i plan veprimeve (programeve) të punës nga subjektet e audituara dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga 12 subjektet e verifikuara vetëm 2 bashki ajo Tropojë dhe Tiranë nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, ndërsa 9 subjektet e tjera kanë hartuar planet e veprimit (programet e punës) dhe kanë kthyer përgjigje KLSH-së, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve. U konstatua se nga 12 subjekte 9, prej tyre kanë raportuar në KLSH me shkrim mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, ndërsa 3 bashki, Tropojë, Bulqizë dhe Fushë Arrëz, nuk kanë raportuar brenda afatit 6 mujor. Në lidhje me raportimin në Këshillin Bashkiak, nga 9 bashki vetëm 3 prej tyre kanë raportuar dhe konkretisht bashkitë Librazhd, Fushë Arrëz dhe Tropojë, ndërsa 6 bashkitë e tjera nuk kanë raportuar në Këshillin Bashkiak.

(Në mënyrë të detajuar kthimi i përgjigjes të zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda afatit 20 ditor dhe 6 mujor, paraqitet në Aneksin nr.1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

Ndërsa realizimi i zbatimit rekomandimeve sipas llojit të tyre paraqitet:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Masa organizative janë rekomanduar 154 masa , nga të cilat nuk janë pranuar 3 dhe janë pranuar 151, prej tyre: Janë zbatuar 69 masa, 66 masa janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar nga 5 subjekte 16 masa organizative *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 41, në vlerën **42,767** mijë lekë, prej tyre janë pranuar 40 rekomandime në vlerën 40,020 mijë lekë, nuk është pranuar nga Bashkia Mat 1 masë shpërblim dëmi në vlerën **2,743** mijë lekë. Nga rekomandimet e pranuar, janë zbatuar 5 në vlerën **4,014** mijë lekë, janë në proces zbatimi apo proces gjyqësor 31 rekomandime në vlerën **34,274** mijë lekë si dhe nuk janë zbatuar 4 rekomandime nga 2 bashkitë Fushë-Arrëz dhe Tropojë në vlerën **2,228** mijë lekë *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave për shpërblim dëmi paraqitet në Aneksin nr. 5 dhe 6 , bashkëlidhur këtij Vendimi).*

C. MASAT DISIPLINORE :

Masa disiplinore janë rekomanduar 86, nga të cilat, nuk janë pranuar 5 masa (nga 2 Bashkitë Tropojë 2 masa dhe Pukë 3 masa) dhe janë pranuar 81, prej masave të pranuar janë zbatuar 72 masa disiplinore, nuk janë zbatuar 9 masa nga 3 bashkitë, Pukë, Gramsh dhe Tropojë *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore paraqitet në Aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

C. MASAT ADMINISTRATIVE:

Masa administrative janë rekomanduar 65, nga të cilat janë pranuar 64 masa dhe nuk është pranuar 1 masë. Janë zbatuar 60 masa administrative dhe nuk janë zbatuar 4 masa administrative nga 3 bashkitë, Tropojë, Pukë dhe Fushë-Arrëz *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave administrative paraqitet ne Aneksin nr. 4, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

Ndërsa realizimi i rekomandimeve për secilin nga 12 subjektet e audituara në mënyrë të detajuar paraqitet më poshtë:

1.BASHKIA KURBIN:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Kurbin rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1267/6, datë 27.07.2019, protokolluar në subjekt me shkresën nr.3788, datë 31.07.2019, ndërsa nga Bashkia Kurbin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, me shkresën nr. 3788/1 prot., datë 19.08.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Për arsye të situatës të krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kurbin 18, masa organizative, janë pranuar të gjitha masat, prej tyre janë zbatuar plotësisht 9 masa , janë në proces zbatimi 7, ndërsa 2 masa nuk janë zbatuar, respektivisht rekomandimi nr. 16.1 dhe 18.1, për të cilat rikërkojmë edhe njëherë zbatimin e tyre si më poshtë:

7.16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin me specialist të fushës, të marrë masa për lidhjen e kontratave për dhënie me qira të pasurisë “Fusha e futbollit” me adresë Lagja nr.4, nr. pasurisë [REDAKTUAR], Indeks Harte H-4, lloji i pronës truall me sipërfaqe 8250 m² si dhe “Godinë zhveshje” nr. pasurie [REDAKTUAR], indeks harte [REDAKTUAR] lloji i pronës “Truall i ndërtesës” me sipërfaqe trualli 105 m² dhe sipërfaqe ndërtese 77 m², në pronësi të saj me shoqërinë [REDAKTUAR] SH.A, për shfrytëzimin e kësaj pasurie, dhe realizimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Kurbin.

9.18.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Kurbin për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2016 - 31.12.2018, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 të nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 42-52 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve)

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar kryetarit të Bashkisë Kurbin, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 7,218,185 lekë.**

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa në vlerën 7,218,185 lekë, të cilat janë pranuar dhe deri me datë 27.02.2020, janë zbatuar 2 prej tyre në vlerën 318,730 lekë, ndërsa për 4 rekomandime janë nisur njoftimet dhe ende nuk ka filluar arkëtimi i vlerës 6,900,355 lekë, për të cilat KLSH i rikërkon Kryetarit të Bashkisë Kurbin zbatimin e procedurave ligjore deri në arkëtimin e vlerës plotë si më poshtë:

1.1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin te marre masa për shpërblimin e demit rezultuar si diferenca ne volume dhe punime te pakryera ne vlerën **723,900 leke** nga shoqëria, ■■■ SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 26.12.2017 me nr. prot. ■■■

2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës ne bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin te marre masa për shpërblimin e demit të rezultuar si diferenca ne volume dhe punime te pakryera në vlerën **398,000 lekë**, nga shoqëria ■■■ SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 06.07.2018 dhe nr. prot. ■■■

3.3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës ne bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin të marre masa për shpërblimin e demit të rezultuar si diferenca ne volume dhe punime te pakryera në vlerën **178,455 lekë**, nga shoqëria ■■■ SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 20.06.2018 dhe nr. prot. ■■■

4.5.1. Rekomandimi: Drejtoria e taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Kurbin, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **5,600,000 lekë** (sipas Tabelës B/10 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë të gjithë subjektet që tregtojnë karburante dhe të aplikojë tarifën për pajisjen me leje/autorizim tregtimi ose të pezullojë aktivitetin deri në pajisjen me lejen/autorizimin e nevojshëm për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, lëndëve djegëse.

4.5.2. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh, por edhe regjistra të tjerë, për bizneset e tjera me natyrë specifike (si p.sh. subjekte që paguajnë rentën minerare, që përdorin pasuritë publike për grumbullimin e bimëve medicinale, peshkimin, etj.)
(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-56 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve)

1.1 BASHKIA KURBIN: (Auditim-Tematik Financiar)

KLSH ka dërguar në Bashkinë Kurbin rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 558/1 , datë 29.09.2019, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 3868/4 datë 02.10.2019, ndërsa nga Bashkia Kurbin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, ishte hartuar program i punës dhe ishte kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, me shkresën nr. 5018, datë 17.10.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kurbin 10 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe pa zbatuar 1 masë (rekomandimi nr. 5). Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces dhe rekomandimet e pa zbatuara, KLSH rikërkon zbatimin e procedurave ligjore deri në zbatimin përfundimtar të rekomandimeve si më poshtë:

4.5.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor të ish Komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë Kurbin. Mbi bazën e këtyre saktësimeve, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë.

Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitore.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 77-87 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve).

2. BASHKIA TROPOJË:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Tropojë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1475/17, datë 27.07.2019 e protokolluar në Bashkinë Tropojë me shkresën nr. 787/43 prot, datë 30.07.2019, ndërsa Bashkia Tropojë për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me 2 muaj vonesë, me shkresën nr. 3547/1 Prot. datë 13.11.2019, protokolluar në KLSH me nr. 1475/11, datë 04.12.2019. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Tropojë 15 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 7 dhe nuk janë zbatuar 6 masa organizative, respektivisht rekomandimet nr. 1, 3, 7, 8, 9 dhe 14), masa, për të cilat **KLSH rikërkon** zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut dhe përcaktim e koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e tij, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.3.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin në afat të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

6.7.1. Rekomandimi: Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për eliminimin e veprime të kryera me arkë mbi limitin e lejuar ligjorë, dhe të bëjë kanalizimin e veprimeve nëpërmjet bankës në lidhje me pagesat që realizohen gjatë një viti ushtrimorë, për të eliminuar përdorimin CASH të veprimeve financiare.

7.8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të analizojë llog. 401-408-“Furnitorë e llogari të lidhura me to” të vitit 2018, dhe të evidentojë të gjitha faturat e pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore për kontratat e lidhura dhe përfunduara, të bëjë kontabilizimin dhe paraqitjen në pasqyrat financiare të vitit 2018 (akoma të pambyllura), dhe pagesën e faturave në vlerën totale **56,223,411 lekë**, duke respektuar radhën e pagesës sipas vitit të krijimit e faturave.

Nuk duhet të planifikohet investime të reja, pa likuiduar kontratat e vjetra.

8.9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë grup pune me specialist të fushës, për evidentimin e të gjitha pronave të kaluar me VKM në pronësi të Bashkisë Tropojë, duke bërë evidentimin mbi gjendjen e tyre, dhe përfundimin e procedurave ligjore për regjistrimin në ZVRPP dhe kontabilitet, dhe për pronat që janë të regjistruara në kontabilitet, të merren masa për regjistrimin e tyre në ZVRPP.

8.9.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Aseteve në Bashkisë Tropojë, të marrë masat dhe të kryej të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë

e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

13.14.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, në bashkëpunim me [REDAKTUAR].” sha Tropojë, si institucion varësie, të nxjerrë përgjegjësitë për prishjen e rrethimit të kaptazhit të ujësjellësit dhe të marrë masa për rindërtimin e rrethimit sipas projektit fillestar, si objekt i një rëndësie të veçantë për jetën e qytetarëve të Tropojë.
(Më hollësisht trajtuar në faqen 44-58 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve)

B-I. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të njësisë publike (Bashkia Tropojë)**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit.. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 11,473,160 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për masat shpërblim dëmi në Bashkinë Tropojë, janë rekomanduar 6 masa me vlerë **11,473,160 lekë**, deri me datë 06.03.2020, është arkëtuar vlera prej **1,240,388 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar vlera **10,232,772 lekë**. Për 5 masa shpërblim dëmi në vlerën **10,232,772 lekë** janë nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe janë njoftuar personat përkatës, por ende nuk ka filluar arkëtimi i detyrimeve përkatëse, për të cilat **KLSH rikërkon** zbatimin e rekomandimeve **si më poshtë:**

1.1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,034,400 lekë**, të mjetit tip “TOYTA” të pakthyer në Bashkinë Tropojë nga ish- Kryetari i Komunës Lekbibaj z. [REDAKTUAR] si person përgjegjës.

1.1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, për kryerjen e inventarit të mjeteve në përdorim të Bashkisë Tropojë, për evidentimin e mjeteve të cilat nuk janë gjendje në fund të periudhës ushtrimore 2017 në vlerën **731,993 lekë**, duke evidentuar përgjegjësit material, nxjerrjen debitorë dhe arkëtimin e vlerës prej **731,993 lekë**. Bashkia Tropojë, nëpërmjet Sektorit Juridik, në çdo rast të mos kthimit të mallit ose të kundër vleftës të njoftojë organet përkatëse për veprime të mëtejshme procedurale.

2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **563,429 lekë**, ndajë të gjithë personave që kanë lidhur kontratë me Bashkinë Tropojë për strehimin e banorëve që kanë përfituar bonos strehimi në vitin 2017 (sipas kontratave që disponon Zv/Kryetarja e Bashkisë Tropojë), ndajë të cilëve nuk është mbajtur dhe derdhur në buxhet tatimin në burim.

3.4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa për arkëtimin e vlerës **521,050 lekë** nga OE [REDAKTUAR] SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. [REDAKTUAR] prot datë 21.09.2018, me objekt “Rikonstruksion shkolla “Asim Vokshi”, Bashkia Tropojë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4.5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **231,900 lekë** nga OE [REDAKTUAR] SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. [REDAKTUAR] prot datë 21.09.2018, me objekt “Ujësjellësi i jashtëm i fshatit Tropojë e Vjetër dhe Rrethinat, Faza II”, Bashkia Tropojë,

vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

5.6.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **7,150,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve, respektivisht:

- vlera **1,000,000 lekë** për subjekti [REDACTED]
- vlera **1,100,000 lekë** për subjektin [REDACTED]
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin [REDACTED]
- vlera **1,050,000 lekë** për subjektin [REDACTED]
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin [REDACTED]
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin [REDACTED]
- vlera **1,000,000 lekë** për subjektin [REDACTED]

Gjithashtu, të verifikojë nëse subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti, të liçencohen duke paguar taksat ose të pezullohen sipas rastit (*Më hollësisht trajtuar në faqen 58-63 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve*)

C.MASA DISIPLINORE:

C/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit të punës.

Nga KLSH për 23 punonjës është rekomanduar masë disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës**”. Nga verifikimi rezultoi se janë zbatuar 20 masa nga të cilat kryetari i Bashkisë Tropojë për 12 punonjës ka vendosur masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”. Nuk janë në marrëdhënie pune 8 punonjës, masa të cilat konsiderohen të ezauruara, ndërsa për 3 punonjës nuk është marë masë disiplinore për të cilët **KLSH rikërkon vazhdimin** e procedurave për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje deri në “largim nga puna**”, si më poshtë:

1. z. [REDACTED], me detyrë Brigadier në Sektorin e Pastrimit.
2. z. [REDACTED], me detyrë punonjës i Ndhimës Ekonomike NJA LLugaj.
3. z. [REDACTED], me detyrë Drejtor Kabineti Bashkia Tropojë.

Shënim: Me vendimin nr.37, datë 18.05.2020 të Kryetarit të KLSH, dërguar me shkresën nr.426/2 prot., datë 22.05.2020, është revokuar masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës”, për z. [REDACTED], me detyrë punonjës i gjendjes civile njësia Administrative Llugaj,Tropojë.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, KLSH me shkresën nr. 1475/8 datë 27.07.2019 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **3 personat**.

Nga verifikimi rezulton se APP me Vendimin nr. 66, datë 28.10.2019 ka vendosur masa dënim me gjobe për 7 persona në shumën **610,000 lekë**. Nga Bashkia Tropojë janë kontabilizuar veprimet dhe deri më datën 06.03.2020 janë arkëtuar nga 4 persona vlera 340,000 lekë, në proces arkëtimi 1 person në vlerën 90.000 lekë, në proces gjyqësor 1 person në vlerën 90.000 lekë, ndërsa për 1 person në vlerën 90,000 lekë edhe pse është nisur njoftimi, por ende nuk ka filluar arkëtimi, për të cilin **KLSH i rikërkon** Bashkisë Tropojë që të fillojë procedurat ligjore për arkëtimin e gjobave të vendosura nga APP për z. [REDACTED], me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Kryetarit të KVO, për zbatimin e Vendimit të APP-së, nr. 66, datë 28.10.2019 për arkëtimin gjobës në vlerën 90,000 lekë.

D/2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor.

KLSH i ka rekomanduar, Kryetarit të Bashkisë Tropojë, t'i kërkojë Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh.

Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim nuk është zbatuar, dhe në kushtet kur Bashkia Tropojë ka në strukturën e saj Kryeinspektor të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit , KLSH i kërkon këtij të fundit që të vendosë gjobë ndaj **2 mbikëqyrësve të punimeve, si më poshtë:**

1.Për operatorin ekonomik “**██████**.” SHPK, me përfaqësues z. **██████**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Shtesë ujësjellësi Valbonë për qytetin Bajram Curri”, Bashkia Tropojë, me sipërmarrës punimesh BOE **██████** SHPK & **██████** SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,240,388 lekë pa TVSH**.

2.Për operatorin ekonomik **██████** ShPK, me përfaqësues z. **██████**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rikonstruksion shkolla “Asim Vokshi”, Bashkia Tropojë, me sipërmarrës punimesh OE **██████** SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **521,050 lekë me TVSH**, dhe në cilësinë e kolaudatorit të punimeve “Shtesë ujësjellësi Valbonë për qytetin Bajram Curri”, Bashkia Tropojë, me sipërmarrës punimesh BOE **██████** SHPK & **██████** SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,240,388 lekë pa TVSH (Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqet 91-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimet nr. 5; 6 dhe 7, datë 05.04.2019).**

(Më hollësisht trajtuar në faqen 66-69 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve)

3.BASHKIA LIBRAZHDI:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Librazhd rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1433/7 Prot, datë 30.07.2019, protokolluar në subjekt me nr.4048 Prot, datë 31.07.2019, ndërsa nga Bashkia Librazhd për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, me shkresën nr. 4267 Prot, datë 19.08.2019, protokolluar në KLSH me nr. 1433/10 datë 22.08.2019. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Librazhd 4 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 3 masa, nuk ka masa organizative të pazbatuara, ndërkohe që është në proces zbatimi 1 masë organizative, për të cilën rikërkojmë zbatimin e plotë të saj, si më poshtë:

1.2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd

(Më hollësisht trajtuar në faqen 27-38 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve)

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Librazhd, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohe në rrugë ligjore (padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **1,483,680 lekë. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,483,680 lekë.******

Nga verifikimi rezultoi se nga KLSH janë rekomanduar 6 masa shpërblim dëmi në vlerën **1,483,680 lekë**, të cilat janë pranuar dhe kontabilizuar në llogarinë 468-debitorë të Pasqyrave

Financiare. Bashkia Librazhd ka njoftuar Operatoren Ekonomik në lidhje më detyrimin por ende deri më datën 27.02.2020, nuk është arkëtuar asnjë lekë.

Sa më sipër KLSH i rikërkon kryetarit të Bashkisë Librazhd, zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës së rekomanduar të pa realizuar në vlerën totale 1,483,680 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 28-33 të raportit përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve)

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP).

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **7 punonjësve.**

Nga verifikimi rezulton se APP me Vendimin nr. 68, datë 04.11.2019 ka vendosur masa dënimi me gjobë **për 7 persona në vlerën 620,000 lekë**, nga Bashkia Librazhd janë njoftuar personat në lidhje me masat e vendosura për likuidim vullnetar, por deri më datën 27.02.2020, ende nuk ka filluar arkëtimi, për të cilat **KLSH kërkon** zbatimin e procedurave ligjore deri në arkëtimin e plotë nga **7 personat në vlerën 620,000 lekë.**

4. BASHKIA PUKË:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Pukë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1432/8, datë 19.08.2019, protokolluar në Bashkinë Pukë me nr. 1/25 prot., datë 23.08.2019, ndërsa nga Bashkia Pukë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, me shkresën nr. 1/28, prot. datë 12.09.2019, protokolluar në KLSH me nr. 1432/13, datë 16.09.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Pukë 11 masa organizative prej tyre janë zbatuar plotësisht 4 masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa, respektivisht rekomandimet; nr. 1.1, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 10.1 dhe 11.1, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 29-36 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve)

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të Njësisë Publike**, Kryetarit të Bashkisë Pukë, që të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore) dhe ndjekur në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **10,020,738 lekë. Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare.

Nga verifikimi rezultoi se për 3 rekomandime në vlerën **10,020,738 lekë**, është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468-debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2019 (bilanci vjetor 2019) vlera **10,020,738 lekë** dhe deri me datë 28.02.2020, është arkëtuar shuma **1,960,892 lekë**, shuma **2,263,120 lekë** është në proces arkëtimi, shuma **1,307,284 lekë** është në proces gjyqësor, ndërsa për shumën **4,489,442 lekë** janë nisur njoftimet por ende nuk ka filluar arkëtimi i tyre.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, KLSH i rikërkon Bashkisë Pukë, zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e plotë të dëmit ekonomik *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-40 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).*

C. MASAT ADMINISTRATIVE:

c.1.Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë Prokurimit Publik.

I. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, dhe në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, për **3 punonjës**, ndërsa APP me Vendimin nr. 72 data 25.11.2019 ka dënuar me gjobë **7 persona në vlerën 600,000 lekë**.

Nga verifikimi rezulton se janë në proces gjyqësor 4 persona në vlerën 270,000 dhe janë nisur njoftimet për 3 persona të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Pukë në vlerën 330,000 lekë. Për të cilat KLSH **rikërkon** ndjekjen e të gjitha procedurave gjyqësore për **3 personat si më poshtë:**

1. z. [REDAKTUAR] me detyrë ish Zv/Kryetar i Bashkisë Pukë, në vlerën 130,000 lekë, është bërë njoftimi nr. [REDAKTUAR] prot , datë 05.12.2019 për shlyerje detyrimi, por është kthyer nga posta pasi nuk është gjetur në adresën e tij pasi, sipas informacioneve është jashtë vendit.

2. z. [REDAKTUAR] me detyrë ish Sekretar i Këshillit Bashkiak, në vlerën 130,000 lekë, është bërë njoftimi nr. [REDAKTUAR] prot ,datë 05.12.2019 për shlyerje detyrimi por është kthyer nga posta pasi nuk është gjetur në adresën e tij, pasi sipas informacioneve është jashtë vendit.

3. z. [REDAKTUAR] me detyrë Inxhinier Ndërtimi në vlerën 70,000 lekë, dhe nga verifikim rezulton se ndaj personit është bere njoftimi nr. [REDAKTUAR] prot ,datë 05.12.2019 për shlyerje detyrimi, por ende nuk ka filluar arkëtimi.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 39-45 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

D. MASA DISIPLINORE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Pukë 8 masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”.

Bashkia Pukë me Vendimin nr. 01, datë 13.01.2020 ka ngritur komisionin disiplinor, i cili pasi është njohur me masat e propozuara , ka vendosur ti propozoj Kryetarit të Bashkisë mos marrjen e masave sipas propozimeve të KLSH. Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr.12 date 13.01.2020 ka vendosur miratimin e propozimit të Komisionit Disiplinor dhe mos marrjen e masave disiplinore për punonjesit.

Nga verifikimi rezultoi se nga 8 masat e rekomanduara nga KLSH rezultoi se 2 punonjës nuk janë në marrëdhënie pune me bashkinë, për 3 punonjës komisioni disiplinor nuk i ka pranuar masat disiplinore, me *argumentin se për të njëjtën shkelje janë trajtuar dy herë*”, ndërsa për 3 punonjës komisioni disiplinor ka vendosur të mos të propozoj masë disiplinore.

KLSH nuk është dakord me vendimin e Komisionit Disiplinor të Bashkisë Pukë për mos marrjen e masës disiplinore ndaj 3 punonjësve, për të cilët i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që t'i rikërkojë Komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 shkronja (c), për 3 punonjësit si më poshtë:**

1.znj. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Financës, Buxhetit dhe Ndihmës Ekonomike.

2.znj. [REDAKTUAR] me detyrë, specialiste Sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore.

3. z. [REDAKTUAR] me detyrë, Përgjegjës e sektorit të Strukturës Përgjegjëse për Pyjet e Kullotat.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 39-44 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

Në lidhje me mosmarrjen e masës disiplinore ndaj 3 punonjësve të cilët janë gjobitur edhe nga APP

KLSH për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt “Blerje ushqimore 2018”, Bashkia Pukë, me fond limit 1,836,354 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2018, pasi është kualifikuar dhe shpallur fitues OE [REDAKTUAR] SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,782,780 lekë, **i ka rekomanduar Bashkisë Pukë**, marrjen e masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në*

shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c) për 3 punonjësit e mëposhtëm:

- 1 z. [REDAKTUAR], me detyrë zv/kryetar i Bashkisë
- 2.znj. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste finance.
3. znj. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste juriste.

Komentet dhe sqarimet e Bashkisë Pukë:

Nga verifikimi rezultoi se, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Vendimin nr. 12, prot, datë 13.01.2020 për miratimin e propozimit të Komisionit Disiplinor duke mos marrë masë disiplinore për këta 3 punonjës, pasi me anë të Vendimit nr. 72, date 25.11.2019 të APP kanë marrë secili një denim me gjoben në vlerën 50,000 lekë, për këtë arsye Bashkia Pukë sqaron se nuk mund të merren dy masa administrative për të njëjtën problematikë.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Nga verifikimi rezulton se për 3 punonjësit, APP me Vendimin nr. 72, datë 25.11.2019 ka vendosur dënime me gjobë për 50,000 lekë/secilin, për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt “Blerje ushqimore 2018”, Bashkia Pukë, me fond limit 1,836,354 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2018, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “N.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,782,780 lekë.

Duke qenë se për të njëjtat shkelje për këta 3 punonjës është kërkuar edhe marrje masë disiplinore, pretendimi i tyre se nuk mund të merren dy masa administrative për të njëjtën problematikë, qëndron. Bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, neni 60 -Parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore pika 6 ku përcaktohet se :“ Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore”, KLSH nuk do rikërkojë marrje masë disiplinore ndaj 3 punonjësve të mëposhtëm:

- 1 z. [REDAKTUAR], me detyrë zv/kryetar i Bashkisë
- 2.znj. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste finance.
3. znj. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste juriste.

5. BASHKIA TIRANË

KLSH ka dërguar në Bashkinë Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1268/20, datë 31.07.2019, ndërsa nga Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së edhe pse është hartuar plani i veprimit dhe janë ngarkuar personat përgjegjës nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor. Bashkia Tiranë ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën nr. 22, datë 14.02.2020. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Tiranë, 17 masa organizative, nuk është pranuar rekomandimi nr. 2 dhe janë pranuar 16 masa, prej tyre janë zbatuar plotësisht 8, ndërsa janë në proces zbatimi 8, nga rekomandimi nr. (3.1 deri 10.1), për të cilat **rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre.**

(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-37 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të njësisë publike (Kryetarit të Bashkisë Tiranë)**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,038,354 lekë.**

Nga verifikimi rezultoi se nga 7 rekomandimet për shpërblim dëmi në vlerën **4,038,354 lekë janë kontabilizuar** dhe pasqyruar në llogarinë 468-debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2019 (bilanci vjetor 2019). Për 2 rekomandimet në vlerën **668,330 lekë** janë realizuar punimet nga OE sipas njoftimeve të bëra nga bashkia, ndërsa për 5 rekomandime në vlerën **3,370,024 lekë**, janë kryer njoftimet por ende nuk kanë filluar arkëtimet. Duke qenë se 5 rekomandime janë konsideruar në proces, KLSH kërkon, vazhdimin e procedurave ligjore (hartimin e padive gjyqësore) deri në arkëtimin e plotë të vlerës **3,370,024 lekë pa TVSH** si më poshtë:

1.1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve ■■■ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **725,972 lekë pa TVSH**, të përfutuar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat".

2.3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve ■■■ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **421,824 lekë pa TVSH**, të përfutuar tepër për likuidim punime të dubluar të zërit transport dheu, të kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)".

3.4.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve ■■■ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për arkëtimin e shumës **233,722 lekë pa TVSH** në situacionin përfundimtar, të përfutuar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia".

4.5.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve ■■■ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **699,396 lekë pa TVSH**, të përfutuar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës "Selaudin Bekteshi".

5.7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve ■■■ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,289,110 lekë pa TVSH**, të përfutuar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga "Muhamet Gjollësja"- "MyslymShyri" - "Rruga e Kavajas" me Kufirin e Njesisë Bashkiake Nr. 10".

(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-42 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

6. BASHKIA MAT:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Mat rekomandimet e auditimit me shkresën nr. nr. 1436/6, datë 22.08.2019, protokolluar në subjekt me nr. 2359, datë 26.08.2019, ndërsa nga Bashkia Mat është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 2359 prot. datë 16.09.2019, protokolluar në KLSH me nr. 1434/11 datë 18.09.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Mat 18, masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 10 masa, janë në proces zbatimi 6 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative, respektivisht rekomandimi nr. 7,1; dhe 12.1, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.4.7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke

ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike.

2.8.12.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe në bashkëpunim me ALUIZNI Mat dhe ZVRPP Mat të merren masa për zgjidhjen e situatës të krijuar duke ndjekur procedurat administrative-ligjore për evidentimin dhe saktësimin e vlerës së detyrimit dhe arkëtimin e taksës së infrastrukturës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 30-37 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të Njesisë Publike Bashkia Mat, (Kryetarit të Bashkisë),** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,101,515 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se janë nisur njoftimet për rekomandimet, por ende nuk kanë filluar arkëtimet për vlerën **1,357,981 lekë**, vlerë e cila është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 429-debitorë të Pasqyrave Financiare nëpërmjet ditarit të veprimeve të ndryshme (bilanci vjetor 2019 i cili nuk ishte mbyllur akoma). Ndërkohë që nuk është pranuar rekomandimi për shpërblim dëmi për shkelje të procedurave të prokurimit në shumën **2,743,534 lekë** ndaj 5 personave përgjegjës respektivisht: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Kjo me arsyetimin pasi janë dorëzuar tek titullari i Bashkisë sqarimet me shkresat nr. 2... prot datë 17.09.2019 nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. anëtarë të komisionit të shqyrtimit të ankesës për tenderin me objekt prokurimi “Rikonstruksion i kanalit ujitës Derjan” dhe shkresës prot 2..., datë 17.09.2019 nga D. T. anëtare e KVO për këtë tender.

Për rekomandimet të cilat janë konsideruar në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa pranuar, KLSH rikërkon zbatimin e procedurave ligjore për shpërblimin e dëmit dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e vlerës plotë sipas rekomandimeve të KLSH në shumën 4,101,515 lekë.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik,** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo duke ja deleguar këtë kompetencë autoritetit kontraktor, për **14** punonjës dhe ish-punonjës.

Nga verifikimi rezultoi se: APP me Vendimin nr.09 datë 11.02.2020 ka dënuar me gjobë **16 persona në shumën prej 1,980,000 lekë**, për të cilat ka dalë nga Titullari i Bashkisë urdhri nr. 150 datë 03.03.2020 për vjeljen e gjobave në zbatim të këtij vendimi, por akoma nuk është proceduar me vjeljen e gjobave për arsye se nga ana e personave është paraqitur kërkesë padia në Gjykatë më datë 11.03.2020. Duke qenë se punonjësit e prekur nga vendimi i APP-së ndodhen në proces gjyqësor **KLSH kërkon** që nga drejtoria juridike të ndiqen te gjitha shkallët e gjykimit deri në arkëtimin e plotë të vlerës prej **1,980,000 lekë për 16 punonjësit**.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 47-49 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

7. BASHKIA GRAMSH:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Gramsh rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 200/5, datë 19.08.2019, protokolluar në subjekt me nr. 5105/1, datë 26.08.2019, ndërsa nga Bashkia Gramsh për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, me shkresën nr. 5105/2, prot. datë 24.09.2019 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 20/10, datë 26.09.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Gramsh 19 masa organizative, janë pranuar të gjitha masat, prej tyre janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe nuk është zbatuar rekomandimi nr. 19.1, për të cilën KLSH rikërkon zbatimin e plotë si më poshtë:

8.19.1.Rekomandimi: Sa sipër, KLSH, rikërkon nga Bashkia Gramsh zbatimin e plotë të këtij rekomandimi, për vjeljen e taksës për truallin për periudhën tetor-nëntor-dhjetor 2016 në vlerën 19,470,000 lekë, nga subjekti ■ sha” Hidrocentrali i Banjës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 34-40 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të njësisë publike, (Kryetarit të Bashkisë Gramsh) që të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 2,307,553 lekë.**

Nga verifikimi rezultoi se për 4 rekomandime në vlerën 2,307,553 lekë është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468-debitorë të Pasqyrave Financiare, janë kryer njoftimet por ende nuk kanë filluar arkëtimet. Duke qenë se 4 rekomandime janë konsideruar në proces KLSH rikërkon, vazhdimin e procedurave ligjore (hartimin e padive gjyqësore) deri në arkëtimin e plotë të vlerës 2,307,553 lekë pa TVSH si më poshtë:

1.1.2. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **729,679 lekë pa TVSH** nga BOE ■ SHPK & ■ SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. ■ prot. datë 30.03.2017, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës automobilistike nga fshati Shëmrizë deri tek ura Skënderbegas (loti I)*”, Bashkia Gramsh, vlerë e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2.1. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,660 lekë pa TVSH** nga OE ■ SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. ■ prot datë 16.07.2018, me objekt “*Sistemim Asfaltim i Lagjes 85*”, Bashkia Gramsh, vlerë e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.3.1. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **999,291 lekë pa TVSH** nga BOE ■ SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. ■ prot datë 10.09.2018, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Lagjja Agjencia*”, Bashkia Gramsh, vlerë e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4.4.2. Për këtë rekomandojmë: Të merren masa nga Bashkia Gramsh, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE █████ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma **359,923 lekë** pa TVSH të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve (12.12.2019). Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).
(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-44 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

D. MASA DISIPLINORE:

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, **KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Gramsh** marrjen e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” e parashikuar në nenin 58 germa (c), ndaj 6 punonjësve.

Nga verifikimi rezultoi se nga 6 masa disiplinore janë zbatuar 3 masa, ndërsa për 3 punonjës nuk është vendosur, masë disiplinore, për të cilat **KLSH i rikërkon** Komisionit Disiplinor rifillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 3 punonjësit **si më poshtë:**

1. znj. █████, me detyrë Specialiste e pagave dhe shpenzimeve në vitin 2017.

2. znj. █████ ish përgjegjëse e Financës nga muaji shkurt 2018 deri 31.12.2019, aktualisht përgjegjëse e zyrës së taksave.

3. znj. █████, specialiste për të ardhurat dhe ndjekjen e debitorëve nga muaji prill 2018 në vazhdim
(Trajtuar më hollësisht në faqet 48-49 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

8. BASHKIA BULQIZË:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Bulqizë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 198/6, datë 17.08.2019, ndërsa Bashkia Bulqizë për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 3962, prot. datë 20.09.2019, protokolluar në KLSH me nr. 198/9, datë 30.09.2019. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Bulqizë 18 masa organizative, janë pranuar të gjitha masat, prej tyre janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 3 dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative, respektivisht rekomandimi nr. 5.1; dhe 14.2; për të cilat rikërkojmë si më poshtë:

1.5.1-Rekomandimi: Titullari dhe Drejtorja e Financës, njësia publike Bashkia Bulqizë të procedojnë sipas kërkesave ligjore për sistemimin kontabël të llogarive (të drejtat për arkëtim), duke krahasuar këtë llogari me gjendjen fizike reale të saj, në të kundërt të nxirret përgjegjësia ndaj personave përkatës, nëse konstatohen këto përgjegjësi.

3.14.1. Rekomandimi: Drejtorja e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 317 subjekte të biznesit të vogël dhe 19 biznesit të madh dhe 8 subjekte shtetërore, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,806,412 lekë.

-për 280 subjekte të biznesit të vogël dhe 32 biznesit të madh dhe 4 subjekte shtetërore, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,859,177 lekë.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3.14.2. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës.

a-Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 9.

b-Zyra e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryejë rakordim me të gjitha subjektet që zhvillojnë në territorin e saj, aktivitet minerar dhe veçanërisht fabrika pasurimi, për përcaktimin e saktë të detyrimeve të pa paguara që kanë ndaj Bashkisë, si edhe ndaj ish komunave, lidhur me taksat dhe tarifave vendore. Pas këtij rakordimi të hartoj listën përfundimtare të debitorëve për këto subjekte dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.

c-Të evidentohen subjektet që administrojnë tokë truall, sipërfaqen e miratuar për ndërtim dhe të parashikojë për këtë sipërfaqe aplikimin e taksës mbi truallin.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 28-33 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të Njesisë Publike Bashkia Bulqizë**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **461,424 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë **461,424 lekë**, të cilat janë pranuar dhe kontabilizuar, janë nisur njoftimet për 2 Operatoret ekonomikë dhe deri me datë 20.03.2020 nuk ka filluar arkëtimi. Duke qenë se 2 rekomandime janë konsideruar në proces, KLSH kërkon, vazhdimin e procedurave ligjore (hartimin e padive gjyqësore) deri në arkëtimin e plotë të vlerës **461,424 lekë** pa TVSH **si më poshtë:**

1.1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit në të gjitha shkallët e gjykimit për vlerën **288,960 lekë** nga OE **SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. **███** prot datë 23.08.2017, me objekt “Sheshi ish Këshilli i Rrethit”, Bashkia Bulqizë, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit në të gjitha shkallët e gjykimit për vlerën prej **172,464 lekë** nga OE **SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. **███** prot datë 12.06.2017, me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës së Shkollës, Blloku i Poshtëm, Lagja e Re, Bulqizë, Faza I nga Pik 1 – Pik. 10 + degëzimet”, Bashkia Bulqizë, vlerë e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-35 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

C. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **KLSH** i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë apo për marrjen e masave disiplinore), **7 punonjësve.**

Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 73, datë 25.11.2019 ka dënuar me gjobë 6 persona në vlerën 600,000 lekë. Duke qenë se për 6 persona për dënim me gjobë nga APP, në vlerën **400,000 lekë**, nuk kanë filluar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre. **KLSH rekomandon** që të kërkohet në Gjykatë lëshimi i urdhrave ekzekutivë, siç përcaktohet në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv për 6 personat në vlerën **600,000 lekë** si më poshtë:

1. znj. [REDAKTUAR] me detyrë Specialiste zyra Juriste në vlerën 70.000 lekë.

2. z. [REDAKTUAR], me detyrë Inxhinier, në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit në vlerën 40.000 lekë.

3. znj. [REDAKTUAR], me detyrë Specialiste në sektorin e financës, në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit në vlerën 40.000 lekë.

4. z. [REDAKTUAR], Inxhinier, në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit në vlerën 100.000 lekë.

5. z. [REDAKTUAR], me detyrë Specialiste në zyrën Juridike në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit në vlerën 100.000 lekë.

6. znj. [REDAKTUAR], me detyrë Specialiste në sektorin e financës, në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit në vlerën 40.000 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-38 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve).

9. BASHKIA FUSHË-ARRËZ:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 199/6, datë 24.08.2019, protokolluar në Bashkinë Fushë Arrëz me nr. 2616 prot datë 27.08.2019, ndërsa Bashkia Fushë Arrëz për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën e saj nr. 2616/1 prot datë 27.08.2019. Nuk ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Ka raportuar në Këshillin Bashkiak.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Fushë Arrëz 12 masa organizative, janë pranuar të gjitha masat, prej tyre janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 3 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative dhe konkretisht rekomandimet nr. 2.1, 6.1, dhe 7.1. për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.2.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 118 subjekte të biznesit të madh e të vogël, debitorë **në shumën 22,528,000 lekë** dhe për 670 familje debitorë për taksa dhe tarifa vendore.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b-Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative për dënimin me gjobë deri në kallëzim penal.

2.6.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë publike, vetë ose nëpërmjet personit autorizues, të marrë masa për miratimin e gjurmëve të auditimit në zbatim të UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, dhe neni 16 pika 2.

3.7.1. Rekomandimi: Njësia publike të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-27 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve)*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të Njësisë Publike Bashkia Fushë-Arrëz**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,665,690 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 1,665,690 lekë shumë e cila është pranuar dhe kontabilizuar dhe deri me datë 13.03.2020 nuk është arkëtuar asnjë lekë, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për detyrimin. Duke qenë se 3 rekomandime janë konsideruar të pa zbatuar KLSH rikërkon, vazhdimin e procedurave ligjore (hartimin e padive gjyqësore) deri në arkëtimin e plotë të vlerës **1,665,690lekë pa TVSH **si më poshtë:****

1.1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,068,475 lekë pa tvsh** nga BOE ██████████ shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9.. prot datë 20.01.2017, me objekt “Rikonstruksioni i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz”, Bashkia Fushë Arrëz, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa për arkëtimin e vlerës **301,640 lekë pa tvsh** nga OE ██████████ shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1.. prot datë 31.07.2017, me objekt “Sistemim Asfaltim i rrugëve të fshatit Fush-Arrëz (Lagjia Fushaxhi)”, Bashkia Fush-Arrëz, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fush-Arrëz, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

3.3.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE ██████████ SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma **295,575 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve (16.08.2019). Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit *(Në rast*

të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).
(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-35 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

C. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, KLSH me shkresën nr. 199/7 datë 24.08.2019 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë apo marrjen e masave disiplinore) për **7 persona**.

Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 77, datë 10.12.2019 ka vendosur masa dënim me gjobe për **7 persona në shumën 1,050,00 lekë**. Për të cilët nga Bashkia Fushë Arrëz i ka njoftuar personat janë kontabilizuar veprimet por ende nuk kanë filluar ndalesat për 5 persona në vlerën 750,000 lekë pasi ndodhen në proces gjyqësor, ndërsa për 2 persona në vlerën 300,000 nuk është kryer asnjë procedurë administrative, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Fushë Arrëz. **KLSH rikërkon** që nga Bashkia Fushë-Arrëz të kërkohet në Gjykatë lëshimi i titullit ekzekutiv, sipas ligjin nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Neni 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, për 2 personat në vlerën **300.000 lekë**, si më poshtë:

1. z. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Tatim Taksave në vlerën 150,000 lekë.

2. znj. [REDAKTUAR] me detyrë Specialiste Juriste e çështjeve juridike dhe prokurimeve në vlerën 150,000 lekë

(Trajtuar më hollësisht në faqet 35-37 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

10. DREJTORINË E KONVIKTEVE DHE SHKOLLAVE TË MESME NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË

KLSH ka dërguar në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme në varësi të Bashkisë Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1682/23 datë 31.07.2019, protokolluar në subjekt me nr. 567 datë 07.08.2019, ndërsa nga Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën e nr. 589 prot, datë 23.08.2019, protokolluar në KLSH me nr.1591/4 datë 30.08.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme në varësi të Bashkisë Tiranë 4 masa , janë pranuar të gjitha masat, prej tyre janë zbatuar plotësisht 3 masa, është në proces zbatimi 1 masë , për të cilën rikërkojmë zbatimin e plotë të saj, si më poshtë:

1.1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në DKSHM, në varësi të Bashkisë Tiranë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

11. DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK (ISH-DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT), NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË.

KLSH ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik (ish Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit), në varësi të Bashkisë Tiranë, rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1682/21 datë 31.07.2019, protokolluar në subjekt me nr. 30352 datë 05.08.2019. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik, për zbatim e rekomandimeve të KLSH-së, ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 1591/4 prot, datë 30.08.2019, protokolluar në KLSH me nr.1268/26 datë 03.09.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Drejtorisë Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (ish-Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit) në varësi të Bashkisë Tiranë, 4 masa, janë pranuar të gjitha masat, prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre (Trajtuar më hollësisht në faqet 12-15 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

12. TIRANA PARKING, INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË:

KLSH ka dërguar në Tirana Parking, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1682/23 datë 31.07.2019, protokolluar në subjekt me nr. 84/7, datë 05.08.2019, Tirana Parking ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve me shkresën nr. 747/5 prot, datë 26.08.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr.1268/25 datë 30.08.2019. Ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar në Tirana Parking, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, 4 masa organizative, janë pranuar të gjitha masat, prej tyre janë zbatuar plotësisht 3 masa, është në proces zbatimi 1 masë organizative, për të cilën kërkojmë zbatimin e plotë të saj si më poshtë:

1.1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre (Trajtuar më hollësisht në faqet 10-12 të Raportit Përfundimtar të zbatimit të Rekomandimeve).

PËR MUNGESËN NË TË ARDHURA DHE SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFICENCËS DHE EFEKTIVITETIT NË INVESTIME ME IMPAKT FINANCIAR NEGATIV NË BUXHET

Bazuar në Vendimet e Kryetarit të KLSH-së për 12 subjekte të pushtetit vendor të evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019, janë rekomanduar në vlerën **1,692,268 mijë lekë**, nga e cila mungesë në të ardhura në vlerën **776,882 mijë lekë** dhe mos efektivitet në shpenzime për investime në shumën **915,386 mijë lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se këto rekomandime janë pranuar në vlerën **1,692,268 mijë lekë**, duke qenë se implementimi i këtyre rekomandimeve kërkon një afat më të gjatë se periudha 6 mujore e raportimit në KLSH, niveli i zbatimit të rekomandimeve për eliminimin e efekteve negative dhe implementimi i tyre në vijim, mbetet për tu verifikuar në auditimin e radhës (Në mënyrë të detajuar niveli i zbatimit të rekomandimeve për mungesë në të ardhura në vlerë dhe mos efektivitet në shpenzime për investime, për secilin subjekt paraqitet në Raportet Përfundimtar të Auditimit për zbatimin e rekomandimeve dhe në formë tabelore në Aneksin Nr. 7, bashkëlidhur këtij Vendimi)

Në ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR

Për afatin e kthimit të përgjigjes brenda afatit 20 ditor, për 6 muaj dhe mbi raportimin në Këshillin Bashkiak (Evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019)

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Afati 20 ditor i kthim përgjigjes	Afati 6 mujor i raportimit	Mbi raportimin në Këshillin Bashkiak
a	b	1	2	3
1	Bashkia Kurbin	po	po	Jo
2	Bashkia Tropojë	jo	jo	po
3	Bashkia Librazhd	po	po	po
4	Bashkia Pukë	po	po	jo
5	Bashkia Tiranë	jo	po	jo
6	Bashkia Gramsh	po	po	jo
7	Bashkia Mat	po	po	jo
8	Bashkia Bulqizë	po	jo	jo
9	Bashkia Fushë Arrëz	po	jo	po
10	DNR2 e punëtorëve të Qytetit Tiranë	po	po	-
11	DKSH të Mesme	po	po	-
12	Tirana Parking	po	po	-
	GJITHSEJT	10	9	3

-Nga auditimi i planit për zbatimin e rekomandimeve dhe kthimin e përgjigjes pranë KLSH brenda afatit 20 ditor, rezulton se nga 12 subjekte, 2 prej tyre nuk kane kthyer asnjë përgjigje brenda këtij afati, dhe konkretisht Bashkitë Tropojë dhe Tiranë.

-Nga auditimi për zbatimin e afatit 6 mujor për raportimin në KLSH, rezulton se nga 12 subjekte, 3 kanë raportuar si Bashkia Tropojë, Bulqizë dhe Fushë Arrëz, ndërkohë që 9 subjekte nuk kanë raportuar .

-Nga auditimi për raportimin në Këshillin e Njësive të Audituar, rezulton se nga 9 Bashki vetëm 2 Bashki kanë bërë raportim si Fushë Arrëz dhe Librazhd,ndërsa subjekte, 7 prej tyre nuk kanë dërguar raport pranë Këshillit Bashkiak

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI Nr. 2.

Masa Organizative: (Evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Kurbin	18	2	16	9		7	
2	Bashkia Kurbin A.Tematik Financiar	10		10	2		7	1
3	Bashkia Tropojë	15		15	2		6	7
4	Bashkia Librazhd	4		4	2		2	
5	Bashkia Pukë	11		11	4		7	
6	Bashkia Tiranë	17	1	16	3		13	
7	Bashkia Gramsh	19		19	11		7	1
8	Bashkia Mat	18		18	10		6	2
9	Bashkia Bulqizë	18		18	13		3	2
10	Bashkia Fushë Arrëz	12		12	6		3	3
11	DNR2 e punëtoreve të Qytetit Tiranë	4		4	1		3	
12	DKSH të Mesme	4		4	3		1	
13	Tirana Parking	4		4	3		1	
	GJITHSEJT	154	3	151	69		66	16
	Në % mbi te pranuarat		1.9	98	45.6		43.7	10.5

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR 3.

Masa Disiplinore: (Evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019)

Në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Kurbin	21		21	21			
2	Bashkia Tropojë	35	2	33	30			3
3	Bashkia Librazhd	10		10	10			
4	Bashkia Pukë	8	3	5	2			3
5	Bashkia Tiranë	-	-	-	-	-	-	-
6	Bashkia Gramsh	12		12	9			3
7	Bashkia Mat	-	-	-	-	-	-	-
8	Bashkia Bulqizë	-	-	-	-	-	-	-
9	Bashkia Fushë Arrëz	-	-	-	-	-	-	-
10	DNR2 e punëtoreve të Qytetit Tiranë	-	-	-	-	-	-	-
11	DKSH të Mesme	-	-	-	-	-	-	-
12	Tirana Parking	-	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJT	86	5	81	72			9
	Në % mbi të pranuarat							

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR. 4.

Masa Administrative: (Evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Kurbin	4		4	4			
2	Bashkia Tropojë	5		5	3			2
3	Bashkia Librazhd	7		7	7			
4	Bashkia Pukë	6		6	5			1
5	Bashkia Tiranë	-	-	-	-	-	-	-
6	Bashkia Gramsh	12		12	12			
7	Bashkia Mat	15		15	15			
8	Bashkia Bulqizë	7	1	6	6			
9	Bashk Fush Arrëz	9		8	8			1
10	DNR2 e punëtorëve te Qytetit Tiranë	-	-	-	-	-	-	-
11	DKSH të Mesme	-	-	-	-	-	-	-
12	Tirana Parking	-	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJT	65	1	64	60			4
	Në % mbi te pranuar							

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR. 5

- Masa Shpërblim dëmi: (Evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019)

në numër

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko Manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
A	B	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Kurbin	6		6	2		4	
2	Bashkia Tropojë	6		6	1		4	1
3	Bashkia Librazhd	6		6			6	
4	Bashkia Pukë	3		3	1		2	
5	Bashkia Tiranë	7		7	1		6	
6	Bashkia Gramsh	4		4			4	
7	Bashkia Mat	4	1	3			3	
8	Bashkia Bulqizë	2		2			2	
9	Bashkia Fushë Arrëz	3		3				3
10	DNR2 e punëtorëve të Qytetit Tiranë	-	-	-	-	-	-	-
11	DKSH të Mesme	-	-	-	-	-	-	-
12	Tirana Parking	-	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJT	41	1	40	5		31	4
	Në % mbi te pranuarat				12.5		77.5	10

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

ANEKSI NR.6,

-Masa Shpërblim Dëmi: (Evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 22.08.2019)

në 000/ leke

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces zbatimi dhe proces gjyqësor	Pa zbatuar
A	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	Bashkia Kurbin	7,218		7,218	318		6,900	
2	Bashkia Tropojë	11,473		11,473	1,240		9,669	563
3	Bashkia Librazhd	1,483		1,483			1,483	
4	Bashkia Pukë	10,020		10,020	1,960		8,059	
5	Bashkia Tiranë	4,038		4,038	496		3,542	
6	Bashkia Gramsh	2,307		2,307			2,307	
7	Bashkia Mat	4,101	2,743	1,357			1,357	
8	Bashkia Bulqizë	461		461			461	
9	Bashkia Fushë Arrëz	1,665		1,665				1,665
10	DNR2 e punëtoreve të Qytetit Tiranë	-	-	-	-	-	-	-
11	DKSH të Mesme	-	-	-	-	-	-	-
12	Tirana Parking	-	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJT	42,763	2,743	40,020	4,014		33,778	2,228
	Në % mbi te pranuarat				10		84,4	5.6

ANEKSI NR 7

Në 000/leke

A.Në të ARDHURA

Rekomandimet dhe niveli i zbatimit per 12 subjekte evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 23.08.2019

Nr .	Emërtimi i subjekteve	Në të ardhura			Rekomandimi KLSH gjithsejtë	Pa pranuar	Pranuar	Nga të cilat:			
		Në sistemin tatimor	Nga qiratë	Të tjera				Pa zbatuar	Në proces zbatimi	Zbatuar	
1	Bashkia Kurbin	107,155		3555	110,710		110,710		107,155	3555	
2	Bashkia Tropojë	37,152			37,152		37,152		37,152		
3	Bashkia Librazhd	8,833		225,000	233,833		233,833		233,833		
4	Bashkia Pukë	10,014			10,014		10,014		10,014		
5	Bashkia Tiranë	206,707			206,707		206,707			206,707	
6	Bashkia Fushë Arëz	22,528			22,528		22,528		22,528		
7	Bashkia Bulqizë	11,027			11,027		11,027		11,027		
8	Bashkia Gramsh	28,436	3,475		31,911		31,911		31,911		
9	B Kurbin A. Tematik (Pasq Fina.2018)	113,000			113,000		113,000		113,000		
	GJITHSEJT	544,852	3475	228,555	776,882		776,882		566,620	210,262	

Në 000/lekë

B.Në SHPENZIME

Rekomandimet dhe niveli i zbatimit per 12 subjekte evaduar për periudhën 01.01.2019 deri 23.08.2019

Nr.	Emërtimi i subjekteve	Në Shpenzime			Rekomandimi i KLSH gjithsejtë	Pa pranuar	Pranuar	Nga të cilat:			
		Shpenzi me operative	Të tjera	Procedura prokurimi 3 ETE				Pa zbatuar	Në proces Zbatimi (Prokuri met 3 –Ete)	Zbatuar	Të tjera në process
1	Bashkia Kurbin			4,744	4,744		4,744		4,744		
2	Bashkia Tropojë		234,538	104,244	338,782		338,782		104,244		234,538
3	Bashkia Librazhd			0					0		
4	Bashkia Pukë			105,560	105,560		105,560		105,560		
5	Bashkia Tiranë		2649	10,164	12,813		12,813		10,164		2649
6	Tirana Parking			306	306		306		306		
7	Drejtoria e Konvikteve dhe Shkollave Tiranë			1045	1045		1045		1045		
8	Drejtoria Nr. 2 e Puntorëve të qytetit			2506	2506		2506		2506		
9	Bashkia Mat			246,627	246,627		246,627		246,627		
10	Bash Fushë Arëz			125,022	125,022		125,022		125,022		
11	Bashkia Bulqizë			8,981	8,981		8,981		8,981		
12	Bashkia Gramsh			69,000	69,000		69,000		69,000		
	Gjithsejtë		237,187	678,199	915,386		915,386		678,199		238,187

Grupi i auditimit

NikoNako
Herman Imeraj
Rezart Golemi
Albano Aliaj